



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 dhe 23 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, dhe neni 4 nga udhëzimi për renditjen e lëndëve për veprim të KSHPK-së në bazë të denoncimeve të parashtruar, KSHPK duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur në vazhdimin e seancës së 51-të, të mbajtur më 02.09.2021, morri:

VENDIM

Denoncimi me numër 12 - 574/1 i datës 27.01.2020 i dorëzuar nga parashtrues -----
-----nga-----, REFUZOHET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave , Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nuk ka elemente për veprim kompetent në lëndën me numër 12- 574/1 e formuar pas denoncimit nr.12-574/1 të datës 27.01.2020.

Lënda me numër 12 -574 e vitit 2020 të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri te parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i Komisionit shtetërorë, me arsytim.

Vendimi i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, me arsytim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Lënda me numër 12 - 574 të vitit 2020, e formuar pas denoncimit me numër 12 - 574/1 të datës 12.06.2020, e dorëzuar në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) nga parashtrues i njohur, „----- nga -----.

Në denoncim janë nxjerrë pohime për pakënaqësi me veprimet e një avokati nga ----- në një procedurë të zhvilluar para gjykatës kompetente për ndarjen fizike të pasurive të paluajtshme, në të cilën parashtruesi ishte propozues dhe kishte marrë një vendim përfundimtar . Parashtruesi i denoncimit thekson se për shkak të dokumenteve të pamjaftueshme për shkak të fajit të avokatit, çështja e tij u la e pazgjidhur dhe kërkesa e tij në procedurë nuk u pranua nga gjyqtari, kështu që ai kërkon nga KSHPK -ja që të shqyrtojë rastin e tij dhe të kontrollojë nëse rasti është gjykuar siç duhet.

Në rastin konkret është një procedurë gjyqësore për ndarjen fizike të pasurive të paluajtshme e cila është zhvilluar para Gjykatës Themelore ----- që nga viti 2002 dhe në të cilën gjykata kompetente ka vepruar në disa raste. dhe u morën vendime gjyqësore, parashtruesi i denoncimit si palë e pakënaqur kundër vendimit të marrë nga kjo gjykatë më 14.05.2013, paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit Shkup e cila veproi dhe mori vendim për të më 27.02.2014. Gjithashtu, nga Gjykata Themelore -----, si gjykatë e shkallës së

parë, u morën vendime për këtë rast në 2018 dhe 2019, me të cilat parashtruesi nuk është i kënaqur sepse iu refuzua propozimi për ndarjen fizike.

Gjatë shqyrtimit të denoncimit të dorëzuar dhe dokumentacionit të paraqitur, KSHPK -ja arrin në përfundimin se veprimet e denoncuara nuk janë aktivitete për të cilat KSHPK -ja ka juridiksion për të vepruar, por janë aktivitete për të cilat juridiksion ka një organ tjetër - Këshilli Gjyqësor i RMV-së, i cili është kompetent për të vlerësuar dhe shqyrtuar veprimin e gjyqtarëve, gjykatave dhe kryetarëve të gjykatave, pas së cilës KSHPK vlerësoi se nuk do të ndërmarrë veprime për veprime të mëtejshme në këtë rast, denoncimi të refuzohet sepse një organ tjetër është kompetent për të vepruar dhe KSHPK nuk ka arsye për veprime kompetente, lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke pasur parasysh të theksuarën më sipër, KSHPK vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

KOMISIONI SHETETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
KRYETAR
Biljana Ivanovska

Dorëzuar deri te:

Arkivi dhe
Parashtruesi

Punoi: J.C.

Miratoi: N.B., Anëtar i KSHPK-së